



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



EKONOMIA DHE BUXHETI

KORRIK 2007

Raporti Mujo

Korrik 2007

Personi i kontaktit: Skënder UKU
Telefon: ++355 (4) 222 920
e-mail: generalmacro.director@minfin.gov.al
www.minfin.gov.al

PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE	1
ZHVILLIMET EKONOMIKE	2
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	2
2. Kursi mesatar i këmbimit	3
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	4
4. Bilanci i Pagesave	5
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	6
6. Kredia për Ekonominë	6
7. Oferta e Parasë	7
8. Depozitat sipas Burimeve	9
SEKTORI FISKAL.....	10
1. Buxheti i Konsoliduar	10
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	10
3. Financimi i Suficitit	11
ANEKSI STATISTIKOR.....	12

VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Korrik, 2007 arriti në 111.1 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin Korrik ishte 2.1 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin Korrik 2007 ishte 89.18 lekë për dollarë dhe 122.24 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Korrik shënuan kuotat 5.82 përqind për depozitat 24 mujore, 5.56 për ato 12 mujore, 4.67 për 6 mujorët dhe 4.01 përqind për depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 10.25 përqind për huatë 12 mujore dhe 13.48 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 693 miliardë lekë në muajin Korrik, duke shënuar një rritje prej rreth 12 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave* për gjashtëmujorin e parë të vitit 2007 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 49.9 milion dollarë
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Korrik, 2007 rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 8.9 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara në Janar – Korrik, 2007 arritën në rreth 134.9 miliardë lekë ose rreth 53.1 përqind e planit vjetor 2007
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 125.9 miliardë lekë ose rreth 41.9 përqind e totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2007


ZHVILLIMET EKONOMIKE

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Korrik 2007 pësoi një rënie prej 0.3 përqind krahasuar me muajin Qershor dhe Maj 2007, kur ky indeks shënonte përkatësisht -0.6 përqind dhe -0.8 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të

një viti më parë ishin - 0.4 përqind, - 1.1 përqind dhe - 0.4 përqind. Rritja më e madhe mujore, gjatë muajit korrik u konstatua në grupin “Qera, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0.4 përqind, rritje e cila erdhi si rrjedhojë e rritjes së cmimeve të qerasë së banesave me 0.3 përqind dhe rritjes së cmimit të ujit të pijshëm me 9.2 përqind, për cigare me rreth 1.2 përqind dhe cmimit të pijeve alkolike me rreth 0.2 përqind. Pësia specifike

Graf - 1



Ndryshimet mujore të IÇK-së

Burimi: INSTAT

relativisht e lartë që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit (rreth 24.4 përqind), bën që ndryshimet e cmimeve për këtë grup të kenë efekte të ndjeshme mbi normën e inflacionit. Ndikimi i tij i drejtpërdrejtë në inflacionin mijor ishte rreth 0.1 pikë përqindjeje. Gjatë këtij muaji rritje shënoi edhe indeksi i cmimeve të grupit “Pije alkolike dhe duhan” me rreth 0.3 përqind, si rrjedhojë e rritjes së cmimeve të cigareve me 0.2 përqind.

Uljen më të madhe prej 1.2 përqind këtë muaj e pësoi indeksi i cmimeve të grupit “Ushqime dhe pije joalkolike”, si rrjedhojë e uljes së cmimeve të nëngrupeve “Zaravate përfshire patatet” me rreth 11.7 përqind, të nëngrupit “Ushqime” me rreth 1.3 përqind, si dhe e [mimeve të nëngrupit “fruta” me rreth 1.3 përqind.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2006	1.4	1.3	1.5	2.4	3.1	2.4
2007	2.9	2.9	2.7	1.9	1.4	2
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2006	3.2	2.8	2.6	2.2	2.9	2.5
2007	2.1					

Burimi: INSTAT

Pesha e lartë specifike që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit (rreth 42.6 përqind), bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte maksimale dhe të menjëhershme mbi normën e inflacionit. Ndikimi i tij i drejtëpërdrejtë në inflacionin mujo ishte 0.51 pikë përqindje. Gjate këtij muaji ulje prej 0.3 përqind shënoi dhe indeksi i çmimeve të grupit “Veshje dhe keputje”, e cila erdhi si rezultat i uljes së çmimeve të nëngrupit “veshje” me 0.2 përqind dhe të çmimeve të nëngrupit “keputje” me 1.0 përqind.


Norma vjetore e inflacionit në muajin Korrik arriti në 2.1 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2006 dhe 2007 paraqiten në tabelën 1.

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Korrik 2007, arriti në 122.24 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie prej 0.67 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Korrik një euro u këmbye me 121.70 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Korrik 2007, arriti në 89.18 lekë/dollarë duke shënuar një rënie prej 2.81 përqind kundrejt muajit Qershor. Në fund të muajit Korrik, dollari amerikan arriti nivelin 88.85 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Korrik të vitit

të kaluar rezulton se monedha shqiptare është vlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 7.77 përqind dhe kundrejt monedhës europiane, Euro, me 0.31 përqind. Mbicimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në

Graf - 2




Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë Korrikut 2007

tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare të lehte duke arritur në rreth 1.371 euro/dollarë.


Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë muajit Korrik përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, rritja e flukseve hyrëse në valutë si pasojë e sezonit turistik, etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Korrik 2007, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 5.56 përqind, duke pësuar një rënie prej 0.17 përqind krahasuar me muajin



Normat e interesit për depozitat



Normat e interesit për huatë

Interesi i huave 6-mujore për muajin korrik arriti në 13.48 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit korrik 2007, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin përkatësisht 7.98 përqind, 7.28 përqind dhe 5.80 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rritje në Yield-et e bonove të thesarit për të gjitha afatet e maturimit.


Qershor, ku normat e interesit shënonin vlerën 5.73 përqind. Rënie për këtë muaj kanë pësuar si depozitat me afat 6-mujor të krahasuara me muajin paraardhës me 0.15 përqind, ashtu dhe normat e interesit për depozitat me afat 3 - mujor me 0.17 përqind krahasuar gjithmonë me muajin paraardhës.

Depozitat me afat 1 - mujor pësuan rritje me 0.14 përqind për muajin Korrik. Krahasuar me të

njëjtën periudhë të një viti më parë, rritje kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Korrik pësoi një rënie 0.34 përqind, duke arritur në 10.25 përqind nga 10.59 përqind që ishte në muajin maj. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësoi një rritje të lehtë me 0.01 përqind, krahasuar me një muaj më parë.

4. Bilanci i Pagesave

Graf - 5




Bilanci i Pagesave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Qershor 2007 regjistroi një sufiçit të përgjithshëm prej 49.9 milionë usd, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.

Graf - 6



Llogaria Korente


Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i defiçitit të llogarisë korente prej 487.1 milion usd i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (në terma neto) për periudhën janar'07-qershor'07 rezultoi:

(i) bilanci tregtar -1279.7 mln usd, (ii) shërbime neto -28.7 mln usd, (iii) të ardhura neto 141 mln usd, (iv) transferta neto 680 mln usd. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në grafikun 6.

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Korrik 2007, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 241.2 milionë dollarë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 302.8 milionë dollarë dhe rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 61.6 milionë dollarë. Në muajin Korrik sistemi bankar



Ecuria e M.V.N. të sistemit në 2007

Burimi: Banka e Shqipërisë

rezulton me një rritje prej 84.8 milionë dollarë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin Qershor, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 43.2 milionë dollarë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 41.6 milionë dollarë.

6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Korrik 2007 arriti në 239.4 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me një vit më parë shënoi vlerën 82.5 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 34.5 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjatë këtij muaji shënoi rritje duke ndjekur kështu të njëjtin trend rritës si në muajt paraardhës


Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 70.7 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 169.3 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, pësoi një rritje të lehte prej 0.5 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 35.5 përqind.

7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Korrik ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës Qershor '07. Kjo ofertë arriti në rreth 693 miliardë lekë në fund të


Graf - 8



Agregati M3 gjatë vitit 2007

Burimi: Banka e Shqipërisë

Graf - 9



Ndryshimi në ofertën e parasë

(Qer '06/Qer '07)


Burimi: Banka e Shqipërisë

rënie prej 0.1 përqind e krahasuar me muajin qershor'07

muajit Korrik duke shënuar një rritje prej 18.9 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin Dhjetor 2006. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 12 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar. Kjo rritje vjetore, erdhi si pasojë e rritjes së depozitave pa afat në lekë me rreth 2 përqind, depozitave në valutë me rreth 22 përqind, depozitave me afat në lekë me rreth 17 përqind dhe rritjes të parasë jashtë sistemit me rreth 3 përqind.

Ndikimin kryesor në rritjen e ofertës monetare gjatë muajit Korrik e kanë patur rritja e depozitave pa afat në lekë, të cilat vetëm gjatë këtij muaji u rritën me rreth 2.24 miliardë lekë si dhe rritja e depozitave në valutë me 7.1 miliardë lekë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, në fund të muajit korrik arriti në 21.9 përqind duke shënuar një rënie te lehtë në krahasim me muajin Qershor. Raporti i parasë jashtë bankave me depozitat në muajin Korrik arriti në rreth 28.1 përqind, duke shënuar një

Graf - 10




Raportet e parës jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 1.78 miliardë lekë në krahasim me muajin qershor. Gjithashtu një rritje prej rreth 7.09 miliardë lekë në krahasim me muajin qershor 2007, pësuan edhe depozitat në valutë. Norma vjetore e rritjes së tyre në fund të muajit korrik arriti në 22 përqind, duke pësuar një rënie në krahasim me muajin paraardhës.

Graf - 11



Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Korrik, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 74.5 përqind të depozitave totale në valutë.


8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Korrik 2007 sektori i individëve, zuri nivelin më të lartë të depozitave pa afat në lekë, me rreth 59.98 përqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 28.79 përqind dhe nga ndërmarrjet publike jo-financiare, me 9.31 përqind. Individët dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 74.5 përqind dhe rreth 21.2 përqind. Familjarët ishin dukshëm burimi më i

rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (95.37 përqind e totalit

Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 444 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 541 miliardë lekë në muajin korrik 2007. Ata ndiqen nga sektori privat (76 miliardë), ndërmarrjet publike jo-financiare (17 miliardë) dhe autoritetet lokale (2.1 miliardë). Institucionet financiare kontribuan me rreth 1.8 miliardë në totalin e depozitave.

Graf - 12



Përberja e depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë


Gjatë muajit korrik 2007, krahasuar me një muaj më parë (qershor '07), niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 8.77 miliardë lekë, kryesisht si rezultat i rënies së depozitave pa afat në lekë dhe të depozitave pa afat në valutë si dhe të depozitave me afat në valutë.

SEKTORI FISKAL

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën Janar - Korrik, janë mbledhur rreth 134.9 miliardë lekë të ardhura, përkundëjt shpenzimeve të përgjithshme prej 125.9 miliardë lekë, që përfshijnë 111.9 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 14 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 79.9 % financim i brendshëm, dhe 20.1 % financim i huaj.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 53.14 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2007, ndërsa shpenzimet përbëjnë 41.9 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 49.7 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 20.1 % e këtij planifikimi.



Treguesit Fiskal, Qershor 2007

(62 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 111.9 miliardë lekë, 30.5 miliardë lekë (27.2 % e totalit të shpenzimeve korrente %) është shpenzuar për personelin, 14.6 miliardë lekë (13.1 %) për interesat, 11.5 miliardë lekë (10.3 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.5 miliardë lekë (1.3 %) për subvencione, 38.2 miliardë lekë (34.1 %) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 9.4 miliardë lekë (8.4 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 6.3 miliardë lekë (5.6 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 52.0 % (shpenzime personeli), 49.5 % (shpenzime për interesat), 48.0 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 55.4 % (subvencione), 54.7 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 36.4 % dhe 43.7 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundëjt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 30 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 8.7 %.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 95 miliardë lekë (ose rreth 54.6 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 6.2 miliarde lekë (47.0 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 22.7 miliarde lekë (53.1 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 10.8 miliardë lekë

2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Korrik 2007 ishin rreth 134.9 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 123.9 miliardë, grantet 119 miliardë dhe të ardhurat jo-tatimore në rreth 10.8 miliardë

Tab - 2 Të ardhurat e realizuara në Janar – Korrik 2007

Burimi	Miliardë Lekë
TVSH	47.7
Tatimi mbi fitimin	11.9
Taksa doganore	5.8
Taksat nacionale	8.7
Akcizat	14.6
Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë	1.0

3. Financimi i Suficitit

Suficiti prej 8.9 miliardë lekë, për periudhën Janar-Korrik, u mbështet në vlerën 9.4 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 0.5 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Korrik disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 19.3 miliardë lekë ose 93.2% e planit.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 20.5 miliardë lekë ose 81.3% e planit.

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhë kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 13.8 miliardë lekë ose 97.2 % të planit të parashikuar. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 17.8 miliardë lekë ose 89.0% të planit dhe shpenzimet kapitale me 2.8 miliardë lekë ose 52.8% të planit.

Aneksi Statistikor

Tab - 1 Ndryshimi i Indeksit të Çmimimeve të Konsumit
Change of Consumer Prices Index

Muaji	Mujor (Monthly)							Mesatar Mujor (Monthly Average)							Vjetor (Annual)							Month
	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	
Janar	-1.3	1.5	-0.2	-0.2	0.8	0.2	0.5	-1.3	1.5	-0.2	-0.20	0.80	0.20	0.50	2.2	6.5	0.0	3.3	3.3	1.4	2.9	January
Shkurt	-1.3	-0.3	0.9	1.9	0.4	0.4	0.5	-1.30	0.62	0.35	0.85	0.60	0.30	0.50	1.5	7.6	1.1	4.4	1.8	1.3	2.9	February
Mars	0.3	0.2	0.4	0.1	0.0	0.1	-0.1	-0.77	0.47	0.37	0.60	0.40	0.23	0.30	2.9	7.5	1.4	4.0	1.6	1.5	2.7	March
Prill	0.8	-0.1	0.8	0.0	-0.3	0.6	-0.2	-0.38	0.33	0.48	0.45	0.23	0.33	0.18	3.0	6.5	2.3	3.2	1.3	2.4	1.9	April
Maj	0.2	-1.6	-1.1	-1.7	-1.1	-0.4	-0.8	-0.26	-0.06	0.16	0.02	-0.04	0.18	-0.02	2.5	4.6	2.8	2.6	2.0	3.1	1.4	May
Qershor	-0.7	-1.5	-1.7	-1.4	-0.5	-1.1	-0.6	-0.33	-0.30	-0.15	-0.22	-0.12	-0.03	-0.12	4.0	3.7	2.6	2.9	2.9	2.4	2.0	June
Korik	-1.2	-0.7	-0.4	-0.2	-1.2	-0.4	-0.3	-0.46	-0.36	-0.19	-0.21	-0.27	-0.09	-0.14	5.6	4.2	2.9	3.1	1.8	3.2	2.1	July
Gusht	-1.0	0.2	0.2	-0.2	0.2	-0.2		-0.53	-0.29	-0.14	-0.21	-0.21	-0.10		4.1	5.5	3.0	2.7	2.3	2.8		August
Shtator	1.1	0.9	0.7	0.1	0.9	0.6		-0.34	-0.16	-0.04	-0.18	-0.09	-0.02		3.5	5.3	2.8	2.0	3.1	2.6		September
Tetor	-0.4	0.1	0.2	0.2	0.4	0.1		-0.35	-0.13	-0.02	-0.14	-0.04	-0.01		1.8	5.8	2.9	2.0	3.3	2.2		October
Nendor	1.9	-0.1	0.4	0.5	0.2	0.9		-0.15	-0.13	0.02	-0.09	-0.02	0.07		2.8	3.7	3.4	2.2	3.0	2.9		November
Dhjetor	5.3	3.2	3.1	3.1	2.2	1.8		0.31	0.15	0.28	0.18	0.10	0.22		3.5	1.7	3.3	2.2	2.0	2.5		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2 Kursi i kembimit
Exchange rate

Leke per njesi te monedhes se huaj (Leke per unit of foreign currency)

Monedha	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007						Currency	
								Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun		Jul
Mesatarja e periudhes														Average of period	
USD	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	98.10	96.04	95.80	95.32	93.36	92.71	91.76	89.18	USD
EURO	132.58	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.08	124.58	125.18	126.13	126.05	125.25	123.06	122.24	EURO
Fundi i periudhes															In the end of period
USD	146.08	137.04	135.97	106.58	92.64	103.58	93.67	96.37	95.55	94.98	93.01	92.45	90.52	88.85	USD
EURO	-	-	137.90	134.32	126.35	122.58	123.70	124.63	126.00	126.47	126.49	124.26	121.83	121.70	EURO

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me baze vjetore

Annual Interest Rates

2007									
Ne perqindje Fundi I periudhes	Dhjetor '06 Dec '06	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	In percent End of period
Norma e remunerimit									Remuneration rate
ne leke	3.85	3.85	3.85	3.85	3.50	3.85	3.85	-	In Lek
ne usd	3.75	3.72	3.72	3.72	3.49	3.72	3.72	-	In USD
ne euro	2.57	2.53	2.61	2.71	1.86	2.78	2.88	-	in EURO
Norma e depozitave									Deposits rates
12-M	5.46	5.59	5.60	5.48	5.22	5.39	5.73	5.56	12-M
6-M	4.64	4.73	4.73	4.64	4.47	4.55	4.82	4.67	6-M
3-M	3.94	3.96	4.02	4.02	3.58	3.68	4.18	4.01	3-M
1-M	3.35	3.64	3.56	3.39	3.45	3.96	3.86	4.00	1-M
Norma e huase									Lending rates
12-M	11.16	12.92	13.46	11.66	10.16	10.12	10.59	10.25	12-M
6-M	12.18	16.60	14.38	12.37	15.38	14.87	13.47	13.48	6-M
Norma e letrave me vlere									Securities rates
Bobo thesari 1/									Treasury bills 1/
3-M	6.25	6.31	6.00	5.69	5.77	5.76	5.68	5.80	3-M
6-M	7.18	7.18	6.84	6.64	7.11	7.18	7.23	7.28	6-M
12-M	7.88	7.85	7.65	7.10	7.79	8.02	7.96	7.98	12-M

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2007
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2007

Te dhena progresive (Progresive Data)									ne milion leke (in million lek)
Nr.	EMERTIMI	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	ITEM
	TOTALI TE ARDHURAVE	18,783	35,375	55,326	74,812	93,235	115,536	134,864	TOTAL REVENUE
I.	Ndihma	5	5	15	55	119	119	119	Grants
II.	Te ardhura tatimore	17,267	32,765	50,829	69,232	87,083	105,525	123,949	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	13,253	25,227	38,919	52,249	66,440	81,212	95,010	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	7,104	12,908	19,690	26,421	33,602	40,669	47,693	V. A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,394	2,918	5,361	6,920	8,698	10,555	11,930	Profit Tax
3	Akcizat	1,991	3,751	5,335	7,616	9,968	12,228	14,654	Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	902	1,568	2,309	3,072	3,832	5,118	6,236	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	1,071	2,441	3,658	4,846	6,208	7,624	8,672	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	791	1,642	2,566	3,375	4,132	5,018	5,826	Custom Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	578	1,278	2,717	4,170	4,778	5,304	6,210	Revenues from Local Gov.
1	Taksa Lokale	491	1,155	2,334	3,534	4,025	4,486	5,110	Local Taxes
2	Tatimi mbi Biznesin e vogel	87	123	384	636	753	818	1,100	Small Business Tax
II.3	Te ardh Buxh. Pavarur	3,436	6,260	9,194	12,812	15,865	19,009	22,729	Social ins
1	Sigurimi Shoqeror	3,007	5,520	8,123	11,364	14,075	16,882	20,198	Social Insurance
2	Sigurimi Shendetesor	429	741	1,071	1,448	1,789	2,128	2,531	Health insurance
III.	Te ardhura Jotatimore	1,511	2,604	4,482	5,526	6,034	9,892	10,796	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shoqiperise	0	0	1,010	1,010	1,010	1,010	1,010	Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	1,405	2,435	3,257	4,145	4,609	5,266	5,871	Income of budgetary institutions
4	Te tjera	106	169	215	371	415	3,615	3,915	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	12,254	30,693	48,925	67,450	86,498	105,385	125,925	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	12,137	26,911	43,184	59,796	76,957	94,158	111,912	Current Expenditures
L1.	Personeli	3,731	7,767	12,148	16,612	21,058	25,589	30,463	Personnel expenditures
1	Paga	3,053	6,364	10,014	13,753	17,358	21,156	25,312	Wages
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	678	1,402	2,134	2,859	3,700	4,433	5,151	Social insurance contributions
3	Politikat e reja pagash								Of which: Contingency
L2	Interesat	2,209	3,687	5,942	7,963	10,067	12,055	14,642	Interest
1	Te Brendshme	2,117	3,443	5,628	7,383	9,368	11,029	13,541	Domestic
2	Te Huaja	92	244	314	580	699	1,026	1,101	Foreign
L3	Shpenzime Operative Mirembajtje	242	2,121	3,711	5,780	7,857	9,790	11,477	Operational & Maintenance
L4	Subvencionet	45	159	633	745	926	1,270	1,455	Subsidies
L5	Shpenzime per Sig.Sociale								
	dhe te tjera	4,784	9,896	15,279	20,919	26,555	32,346	38,208	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqerore	4,418	8,992	13,671	18,509	23,370	28,490	33,550	Social insurance
2	Sigurime Shendetore	365	905	1,608	2,409	3,185	3,856	4,658	Health insurance
L7	Shpenzime per Buxhetin Lokal	735	1,866	3,196	4,523	6,253	7,909	9,396	Local Budget
L8	Shpenzime te tjera	391	1,415	2,275	3,254	4,242	5,199	6,271	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesise	66	147	225	295	366	436	515	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	325	1,268	2,050	2,959	3,876	4,763	5,756	Social assistance
3	Kompensim per ish te permdjekurit politike								Compensation for ex political prisoners
L9	Kompensim ne vleren e pronareve								Property Compensation
II.	Fondi Rezerve								Reserve fund/contingency
III.	Shpenzime Kapitale	117	3,782	5,741	7,654	9,541	11,227	14,013	Capital expenditures
1	Financimi Brendshem	6	3,552	4,982	6,106	7,431	8,717	11,204	Domestically financed
2	Financimi Huaj	111	229	759	1,548	2,110	2,510	2,809	Foreign financed
	DEFICITI	6,529	4,682	6,401	7,362	6,738	10,150	8,940	Overall Deficit
	FINANCIMI DEFICITIT	-6,529	-4,682	-6,401	-7,362	-6,738	-10,150	-8,940	Deficit Financing
	Brendshem	-6,258	-4,312	-6,416	-7,926	-7,449	-10,445	-9,389	Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	0	8	30	38	42	44	55	Privatization receipts
	Hua-marje e brendeshme	2,017	4,610	2,840	6,495	2,972	3,436	10,717	Domestic Borrowing
	Te tjera	-8,275	-8,930	-9,286	-14,459	-10,463	-13,925	-20,161	Other
	I Huaj	-272	-371	15	564	711	295	449	Foreign
	Hua afatgjate(e marre)	99	230	840	1,400	1,854	1,950	2,301	Long-term Loan(Drawings)
	Ndryshimi i gjendjes se arkesh*	6	-6	-90	99	143	447	467	Chang. of stat. Account*
	Ripagesat	-377	-595	-735	-936	-1,286	-2,102	-2,319	Repayments
	KAPITULI KRYESORE								Main indicators
	Financimi i Brendshem i Deficitit	-6,258	-4,312	-6,416	-7,926	-7,449	-10,445	-9,389	Domestically financed deficit
	Deficiti Pergjithshem	6,529	4,682	6,401	7,362	6,738	10,150	8,940	Overall Balance
	Te ardh.-Shpen.nga Sig. Shoq.dhe Shend.	-1,348	-3,636	-6,086	-8,107	-10,690	-13,337	-15,479	Soc.& health insur.contr.-outlays

* "Ndryshimi i gjendjes se arkesh" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja

"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing D

Tab - 5 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT INSTITUCIONAL PER VITIN 2007
Expenditures by central institutions during the year 2007

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks)

Ministria ose Institucioni	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Ministria ose Institucioni
Totali	12,254	30,693	48,925	67,450	86,498	105,385	125,925	Total
Presidenca	6	14	23	40	42	52	64	President
Kuvendi	62	123	188	247	317	388	480	Parliament
Keshilli i Ministrave	26	69	127	376	400	432	565	Council of Ministers
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	38	122	190	532	655	751	873	Ministry of Economy, Trade & Energy
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe mbrojtjes se Konsumatorit	65	298	555	755	1,214	1,501	1,922	Ministry of Agriculture, Food & Consumers Safety
Ministria e Puneve Publik, Transportit dhe Telekomunikacionit	169	3,801	5,092	6,247	7,715	9,347	11,483	Ministry of Public Work, Transport & Telecommunication
Sistemi i regjistrimit te pasurise se paluajtshme	13	33	62	91	119	145	178	Immovable Property Registration
Ministria e Financave	21	74	101	137	175	217	246	Ministry of Finance
Ministria e Arsimit dhe Shkences	1,423	3,088	4,979	6,994	9,114	11,111	13,485	Ministry of Education & Science
Ministria e Turizmit, Kulture, Rinise dhe Sporteve	47	157	260	375	484	614	742	Ministry of Tourism, Culture, Youth & Sport
Ministria e Shendetesise *	865	2,377	3,988	5,672	7,274	8,852	10,655	Ministry of Health
Ministria e Drejtësisë	97	270	462	641	847	1,038	1,208	Ministry of Justice
Ministria e Puneve te Jashtme	68	254	346	525	658	784	919	Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Brendshme	698	1,411	2,336	3,278	4,200	5,226	6,294	Ministry of Interior
Ministria e Mbrojtjes	527	1,552	3,123	4,078	5,034	5,979	6,836	Ministry of Defense
Sherbimi Informativ i Shtetit	57	125	197	284	382	441	525	State Information Service
Drejtoria e Radio-Televizionit	24	49	74	96	133	164	191	Department of Radio and Television
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	3	10	25	34	43	51	57	General Directorate of Archive
Drejtoria e Rezervave se Shtetit	5	11	19	27	34	43	50	Directorate of State Reserves
Akademia e Shkencave	29	64	103	149	189	223	270	Science Academy
Sherbimi i Kontrollit te Shtetit	6	20	38	58	82	102	120	State Audit Commission
Ministria e Punes, Ceshjeve Sociale dhe Shanseve te barabarta**	4,694	10,213	15,776	21,541	27,371	33,419	39,428	Ministry of Labor and Social Affairs & Equal Possibilities
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	40	105	180	283	378	501	589	Ministry of Environment, Forestry & Water Administration
Ajensia Kombetare e Privatizimit								National Agency for Privatization
